

## AKT- THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### “URIMI-SH TRANSPORT” shpk

Ne Durres, sot me date, 13/01/2022 (dymije e njezet e dy ), me cilësinë e “ Ortakeve themelues” **Z. Urim Sherolli** , madhor,dhe me zotesi juridike dhe per te vepruar.

I cili me cilesine e “Ortakut themelues” kerkuan redaktimin e ketij Akti Themelimi, nepermjet te cilit deklarom se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe me inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregetare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor,Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregetare, me pergjegjesi te kufizuar, “**URIMI-SH TRANSPORT** “shpk

#### KREU I

##### Neni 1

##### Krijimi

#### Shoqeria “**URIMI-SH TRANSPORT**” shpk

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

##### Neni 2

##### Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKR, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria “**URIMI-SH TRANSPORT** “shpk, eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga ortaket **Z. Urim Sherolli** te cilet nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregetare dhe mbulojn personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakeve perben kapitalin e rregjistruar te Shoqerise.

##### Neni 3

##### Selia

Shoqëria e ka selin në: **Lagjja nr. 3, Rruga Egnatia, Godina nr.452 , ap 1, Durres.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filial, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Assamblese se ortakeve.



**Neni 4**  
**Objekti i veprimtarise**

Transport rrugor nderkombetar mallrash per te trete e me qira

**Neni 5**  
**Kohezgjitja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimi

**KREU II - Kapitali**

**Neni 6**  
**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestare i shoqërisë është 100 000 (njqindë mijë) lekë,  
Pjesemarrja themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

- 1- Ortaku themlues **Z. Urim Sherolli** : zoterues i 1 ( nje ) kuote me vlere te pergjithshme 100,000 leke, qe perbene 100 % te kapitalit themeltare te shoqerise.

Kapitali themltare eshte i nenshkruar plotësisht nga ortaku themelues ne masën 100%  
Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme .  
Kontributi I ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të lujtshme/të palujtshme apo të drejta )  
Ortaket përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri ne vlerën e kontributit të kapitalit themeltar të shoqërisë ;

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

Kuota e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.



Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### **KREU III - ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarres**

Assambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise. Assambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statute duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Assambleja e ortakeve vendos per çeshtje si :

- a) Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga Assambleja e ortakeve regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per :

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim , perveç rastit



kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

**Neni 9**  
**Administrimi**

Administrator i shoqerise “**URIMI-SH TRANSPORT** “shpk, caktohet, ortaku themelues **Z. Urim Sherolli** , e cila emerohet per nje afat 5 vjeçar me te drejte riperteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Assambleja e ortakeve te shoqerise.

**Neni 10**  
**Kompetencat**

Administratori ka te drejte e detyrohet te :

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregetare, te vednosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) Perfaqesoje shoqerine tregetare;
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) Pergatise dhe nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shpendarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim
- e) Krijoi nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryej regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise sic parashikohet ne ligjin per QKR.
- g) Raportoi perpara asmbleses se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregetare.

Administratori eshte i detyruar te therrase ne mbledhjen e asamblese ne rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqërisë nuk I mbulojnë detyrimet e kerkueshme Brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria , brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj,propozon te bleje nga nje ortak pasuri,qe kane vlere me te larte se 5 per qind te asetëve te shoqerise,qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.



Administratoret , si se bashku edhe vecas njeri tjetrit, kane te drejt te kryejn te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtzakonshem. Administratoret e perfaqesojne Shoqerine perpara te gjithe personave fizike e juridike, publike dhe /ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratoret kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te Shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ja jep shprehimisht ortakeve te Shoqerise.

Administratoret angazhojn Shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk mer persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti I administratorit e kalonte objektin e Shoqerise ose per te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

### **Neni 11**

#### **Viti Financiar**

Viti Financiar I Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht , viti I pare Financiar fillon nga data e regjistrimit te Shoqerise ne QKR dhe mbyllet ne 31 dhjetor

### **Neni 12**

Shperndarja ose prishja e Shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) me vendim te ortakeve themelues
- c) me hapjen e procedurave te falimentimi
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 , date 3.5.2007 “Per Qendren Kombtare te Regjistrimit”
- e) me vendim te Gjykates

Ne kete rast Asambleja merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te Shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ shoqeri ne likuidim e siper”

### **Neni 13**

#### **Baza ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.



Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë

#### **Neni 14**

#### **Dispozita përfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua në 4 (katër) ekzemplare në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mesipërmi pasi miratohet në parim dhe nën parashikimin nga Ortaket themelues të shoqërisë tregtare nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

ORTAKET THEMELUES

**Z. Urim Sherolli**

URIM SHEROLLI

